



**URDHËR**  
**Nr. 123, datë 26.2.2020**

**PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 632, DATË 29.8.2018, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SËMUNDJEVE INFEKTIVE, TË DETYRUESHME PËR T'U RAPORTUAR NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE, PUBLIKE OSE PRIVATE TË TË GJITHA NIVELEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar dhe të nenit 29, pika 6, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik", të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Në urdhrin nr. 632, datë 29.8.2018, "Për miratimin e listës së sëmundjeve infektive, të detyrueshme për t'u raportuar nga institucionet shëndetësore, publike ose private të të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë", të shtohet pika si më poshtë:

Në germën "A", "Lista e sëmundjeve infektive dhe shkaktarëve të tyre", të shtohet numri rendor, "79. **COVID-19** (Koronavirusi) shkaktohet nga virusi SARS-COV2. Raportohet brenda 24 orëve nëpërmjet survejancës së rastit, survejancës laboratorike dhe survejancës bazuar në ngjarje."

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Instituti i Shëndetit Publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
Ogerta Manastirliu**

